REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**

# VENDIM

**Nr. 168, datë 17.3.2021**

## PËR

## KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKIVE VORË DHE SHIJAK TË OBJEKTEVE ARSIMORE, KOPSHTI "MUÇAJ", BASHKIA VORË, KOPSHTI NR.1 DHE SHKOLLA E MESME "16 SHTATORI", BASHKIA SHIJAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkive Vorë dhe Shijak, përkatësisht, të objekteve arsimore kopshti "Muçaj", Bashkia Vorë, kopshti nr.1 dhe shkolla e mesme "16 Shtatori", Bashkia Shijak, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Vorë e Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ

| Nr. | Bashkia | Njesia Administrative | Niveli | Emertimi | Tipologjia e Nderhyrjes | Financimi i Ndertimit | Siperfaqe (m$^2$) | Vlera e Projekt Idese | Vle e projektit te zbatimit dhe ndertimit | Vlera e Mbikeqeresit | Vlera e koaludimit | Vlera totale e objektit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 19 | Shijak | Shijak | e mesme | Gjimnazi 16 Shatori | Ndertim | Buxhet GoA | 2,400.0 | 838,420.45 | 80,880,000.00 | 848,302.26 | 98,146.50 | 82,664,869.2 |
| 20 | Shijak | Shijak | kopesht | Nr. 1 | Ndertim | Buxhet GoA | 1,160.0 | 405,236.55 | 39,092,000.00 | 410,012.76 | 47,437.48 | 39,954,686.7 |
| 36 | Vore | Mucaj | kopesht | Mucaj | Ndertim | Buxhet GoA | 516.0 | 75,726.67 | 17,389,200.00 | 182,384.99 | 21,101.50 | 17,668,413.1 |
| | | | | | | *TOTAL* | *4,076.0* | *1,319,383.7* | *137,361,200.0* | *1,440,700.0* | *166,685.5* | *140,287,969.* |

NR.PROT. 1439/1
DATË 18.3.2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
BASHKIVE VORË DHE SHIJAK
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE